



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 7112 prot.

Shkodër, më 01.04. 2026

VENDIM

Nr. 24, datë 30.03.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 84, DATË 18.12.2025 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2026–2028 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54, shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar; Vendimit nr. 75, datë 06.02.2026, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut”; VKB nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, pika 1 germa g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, sipas tabelës së SMBV, pjesë përbërese e këtij vendimi.

2. Fondi i pagave për punonjesit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga fondet e trashëguara nga viti 2025 pjesë e buxhetit të bashkisë të vitit 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 27 vota

Vota Pro	27
Vota Kundër	8
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	31.03.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR
Oltion LULI

Ishte

Raporti : BV5 - Numri i Punonjësve të NJQV

NJQV : 141- Bashkia Shkodër

Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	645	20
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	248	
NUMRI I PUNONJËSVE		1,094	30
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)		1,124	
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		20	

BV5 - Numri i Punonjësve të NJQV

Dokumenti përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxheti 2026 - Miratuar nga Këshilli Bashkiak i NJQV (Faza III).

Bëhet**Raporti : BV5 - Numri i Punonjësve të NJQV**

NJQV : 141- Bashkia Shkodër

Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	659	28
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	248	
NUMRI I PUNONJËSVE		1,108	38
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)		1,146	
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	7	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		7	

BV5 - Numri i Punonjësve të NJQV

Dokumenti përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxheti 2026 - Miratuar nga Këshilli Bashkiak i NJQV (Faza III).